



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE
TË AGJENCISË PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
PËR VITIN 2019**

Prishtinë, qershor 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

“ETIKA Co” Shpk ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, në emër të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, në konsultim me menaxherin e kontratës Mujë Gashi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga ETIKA Co shpk, nga Ymer Mehmeti, udhëheqës i ekipit si dhe Burim Selmani, anëtar i ekipit.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	7
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	11
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	12
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	14

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Procesi i përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore ishte menaxhuar në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli në AIP, tregon që nevojiten kontrolle dhe angazhim në vënie në funksion të sistemit e-pasuria.

Sa i përket zbatimit të rekomandimit nga viti i kaluar, mbetet i pazbatuar dhe ka të bëjë me mos funksionimin e E-pasurisë.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2019 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Drejtori i Përgjithshëm është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Agjencisë për Informim dhe Privatësi (më tutje AIP), nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga AIP. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Drejtori i Përgjithshëm i AIP-së dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime)dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori i Përgjithshëm në mungesë të Mbikëqyrësit Kryesor Shtetëror të Agjencisë është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të AIP-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyesh mërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv në AIP kërkojnë procese të rishikimit dhe vendosjen e mekanizmave të cilët sigurojnë zbatimin e plotë të procedurave dhe proceseve të tjera të kontrollit. Testet kanë treguar se nevojiten përmirësime sa i përket vënies në funksion të sistemit e-pasuria.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	365,203	258,779	215,616	83%	220,757	212,288
Granti i Qeverisë -Buxheti	365,203	258,779	215,616	83%	220,757	212,288

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 106,424€. Ky zvogëlim ishte rezultat i vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore.

Në vitin 2019, AIP ka shpenzuar 83% të buxhetit final ose 215,616€, me një rënie prej 2% krahasuar me vitin 2018. Megjithatë, se si ishte realizuar buxheti sipas kategorive janë dhënë shpjegimet në tabelën në vijim.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	365,203	258,779	215,616	83%	220,757	212,288
Pagat dhe Mëditjet	228,305	125,881	125,881	100%	120,139	117,811
Mallrat dhe Shërbimet	130,448	130,448	88,130	68%	99,286	94,056
Shërbimet komunale	6,450	2,450	1,605	66%	1,332	421

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikimin që kanë pasur janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 102,424€, me vendim të Qeverisë për kursime buxhetore. Shpenzimet në këtë kategori ishin 100% e buxhetit;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar nuk kishte ndryshime. Në këtë kategori shpenzimet ishin 68% e buxhetit; dhe
- Buxheti final për shërbimet komunale krahasuar me atë fillestar ishte zvogëluar për 4,000€ si rezultat i vendimit të Qeverisë për kursime buxhetore. Te kjo kategori, shpenzimi i buxhetit ishte vetëm 1,605€ apo 66%, për arsye se të gjitha shpenzimet tjera i ka kryer MAP-i me përjashtim të shpenzimeve të telefonisë fikse.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 125,881€, i cili ishte shpenzuar në tërësi (100%). Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 24 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 19. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 3 të rinj. Kemi testuar 35 mostra për teste substanciale në vlerë 23,855€, si dhe 7 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Lidhur me këtë, ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e pagave si dhe nga testimet tona nuk kemi identifikuar ndonjë çështje për t'u raportuar. Nga mostrat e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë shërbimet komunale në vitin 2019 ishte 130,448€, ndërsa ishin shpenzuar 88,129€. Shpenzimet për këto kategori kanë të bëjnë me: shpenzime të trajnimit, shpenzimet e udhëtimit, shpenzime për telefoni mobile, shpenzime të mirëmbajtjes dhe shpenzime të tjera.

Kemi testuar 36 mostra për teste substanciale në vlerë 37,203€, si dhe 3 mostra për teste të pajtueshmërisë. Nga mostrat e testuara nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuria kapitale mbi 1,000€ e prezantuar në PFV ishte në vlerë 20,616€, pasuritë jo-kapitale nën 1,000€ ishin në vlerën 7,835€, ndërsa vlera e stoqeve ishte zero.

Kemi testuar pesë (5) mostra për teste substanciale, si dhe pesë (5) mostra për teste të pajtueshmërisë. Nga testimet tona, ne kemi identifikuar çështjen në vijim:

Çështja B1 - Mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria

- Gjetja** Rregullorja Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare thekson se pasuritë kapitale duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël - SIMFK ndërsa pasuritë jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e - Pasuria.
- Përkundër rekomandimit të vitit të kaluar lidhur me pasuritë, Agjencia ende nuk e ka në funksion sistemin e-pasuria dhe se raportimi i pasurive nën 1,000€ në PFV bëhet nga formati Excel.
- Lidhur me këtë, Agjencia kishte certifikuar zyrtarin në janar të vitit 2020 dhe është zotuar se këtë sistem do të vë në funksion në prill të vitit 2020.
- Ndikimi** Mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria dhe raportimi i pasurive nën 1,000€ në PFV jo nga regjistri i e-pasurisë është në kundërshtim me rregulloren Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare si dhe rrit rrezikun e shpalosjes jo të saktë dhe të plotë të pasurive nën 1,000€ në PFV.
- Rekomandimi B1** Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj funksionalizimin e sistemit e-pasuria në mënyrë që prezantimi i pasurive nën 1,000€ në PFV të bëhet nga sistemi e-Pasuria.

2.3 Detyrimet

2.3.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019 ishte 1,345€³. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Arsyeja e mos pagesës ishte pranimi i faturave pas kalimit të afatit të zotimit.

2.3.2 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve të kontigjente e paraqitur në PFV ishte zero.

2.3.3 Detyrimet kontraktuale

Pasqyra e detyrimeve kontraktuale në fund të vitit 2019, ishte 0.00€⁴. Nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim në fushën e detyrimeve

³ Kjo shumë është prezantuar nga entiteti i audituar

⁴ Kjo shumë është prezantuar nga entiteti i audituar

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Në bazë të kërkesave ligjore, AIP nuk i plotëson kriteret për themelimin e NjAB-së. Ne inkurajojmë menaxhmentin që të bëjë një rishikim të nevojave për auditim të brendshëm dhe të konsiderojë mundësinë e arritjes së një marrëveshje me ndonjë organizatë tjetër të sektorit publik që të shfrytëzojë shërbimet e auditimit të brendshëm. Nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim në këtë fushë.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2019 ka rezultuar me një rekomandim. AIP kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohet rekomandimi, mirëpo ky rekomandim ende nuk është zbatuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimit dhe mënyrës se si është trajtuar ai, shih tabelën në vijim:

Tabela 3 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj funksionalizimin e sistemit epasuria dhe trajnimin e zyrtarit të pasurive nga ana e MAP-it.	Menaxhmenti është zotuar se në prill do të vë në funksion sistemin e-pasuria.	I pa zbatuar
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj funksionalizimin e sistemit e-pasuria në mënyrë që prezentimi i pasurive nën 1,000€ në PFV të bëhet nga sistemi e-Pasuria.		

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit për vitin 2019 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: "Etika - Co" SHPK

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Agjencisë për Informim dhe Privatësi (ish Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale), për vitin 2019 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Bujar Sadiku,

Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Informim dhe Privatësi (ish Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale).

Data: 27 Prill 2020, Prishtinë,

